



Aktiviteti i USAID-it në Kosovë - Promovimi i Investimeve dhe Qasja në Financa

Fondi për Rritjen e Bizneseve të Diasporës

Deklarata Vjetore e Programit #2

Nr.: APS-2024-002

Shpallur nga: Aktiviteti i USAID-it në Kosovë - Promovimi i Investimeve dhe Qasja në Financa.

Data e shpalljes: 8 gusht 2024.

Data e mbylljes: 31 korrik 2025.

Aplikimet e hershme inkurajohen fuqimisht.

Lënda: Ftesë për bizneset dhe investitorët e kualifikuar të diasporës për dorëzim të aplikacioneve për financim të granteve për të térhequr mundësi investimi në Kosovë.

Qëllimi: Pranimi i propozimeve nga bizneset dhe investitorët e kualifikuar të diasporës për forcimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike përmes projekteve të reja investuese.

Pranohen:

- Ndërmarrësit e diasporës të cilët fillimisht kanë lindur dhe kanë jetuar në Kosovë, por kanë emigruar dhe kanë jetuar për më shumë se tri vite jashtë vendit.
- Ndërmarrësit e diasporës të cilët janë pasardhës (gjenerata të reja) të prindërve kosovarë, duke u zgjeruar deri në gjeneratën e dyte, me origjinë nga Kosova.
- Bizneset e themeluara të diasporës me kohëzgjatje të operimit në Kosovë deri në 36 muaj.

Kriteret për kualifikim: a) Aplikantët duhet të sigurojnë financim nga një bankë dhe të dorëzojnë kontratën e kredisë së bashku me formularin e aplikimit. b) Kredia duhet të garantohet nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKG).

Financimi: Shumat e granteve të dhëna do të varojnë nga €5,000 në €30,000 (ekuivalenti i \$33,000). Grantet që bien nën €5,000 ose mbi €30,000 (ose \$33,000) mund të merren parasysh si raste të veçanta nëse ato janë të arsyetuara mirë, krijojnë vlerë të shtuar për qëllimin e fondit dhe nëse miratohen nga USAID.

Përdorimi i fondit: Konsolidimi i biznesit, trajnimi i stafit, menaxhimi organizativ, planifikimi afarist dhe financiar, shërbimet e marketingut, blerja e makinerive dhe shërbimet tjera përkatëse këshilluese.

Informacioni: Informacione shtesë për Fondin për Rritjen e Bizneseve të Diasporës mund të gjenden në Rrjetin Kosovar për Investime dhe Financa në:
<https://www.facebook.com/KosovoInvestemandFinanceNetwork>

I. Historiku i projektit

Aktiviteti i USAID-it Promovimi i Investimeve dhe Qasja në Financa (në tekstin e mëtejmë “Aktiviteti”) financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Aktiviteti është projekt pesëvjeçar që synon të forcojë kapacitetin e sektorit privat për të ofruar rritje ekonomike të qëndrueshme përmes dy objektivave që përforcojnë njëri-tjetrin:

- Objektivi 1: Tërheqja e investimeve.
- Objektivi 2: Rritja e qasjes dhe përdorimit të financimit të diversifikuar.

Aktiviteti adreson një nga kufizimet kryesore për rritjen e sektorit privat: mungesën e qasjes në forma alternative të investimeve dhe mungesën e financimit. Rritja e burimeve të investimeve dhe financimit do të mundësojë zgjerimin e sektorit privat, i cili zgjerim do të krijojë vende pune produktive, do të rrisë eksportet dhe do të përvetësojë teknologji dhe praktika të reja afariste. Në këtë mënyrë, Aktiviteti do të kontribuojë në qëllimin e përgjithshëm të USAID-it për rritjen e mundësive për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse demokratike dhe ekonomike.

2. Sfidat dhe mundësitë

Ka tregues të shumtë që tregojnë potencialin e diasporës kosovare për të përmirësuar mirëqenien ekonomike në Kosovë. Flukset hyrëse të remitencave përbëjnë 12% të Bruto Produktit Vendor (BPV) të Kosovës, remitenca këto që përbëjnë burim jetik financiar për ekonominë vendore. Vendet gjermanishtfolëse, përkatësisht Gjermania, Zvicra dhe Austria, ku diaspora e Kosovës është e përqendruar më së shumti, janë burimi kryesor i investimeve të huaja direkte (IHD). Sidoqoftë, gjithnjë e më shumë ka dëshmi në rritje se bizneset e diasporës janë duke bërë investime në Kosovë si në sektorin e prodhimit poashtu edhe në atë të shërbimeve.

Për të thelluar rolin e diasporës së Kosovës në ekonominë e Kosovës, qasja në financa është çështje kyçe. Aktualisht, financimi është pengesë kryesore për investorët e diasporës. Bankat komerciale janë konservatore ndaj financimit të planeve të investimeve nga investorët e diasporës, pasi teknologjia e tyre e kreditimit bazohet në rrjedhën ekzistuese të parave të gatshme të kompanive që kërkojnë financim kur vlerësojnë aftësinë kreditore të aplikantëve afaristë. Bazuar në anketën e kryer nga organizata joqeveritare vendore Germin, me 548 të anketuar nga diaspora dhe 30 intervista me biznesmenë të diasporës, 24% e të anketuarve kanë deklaruar se qasja në financa mund të ndihmojë në rritjen e vullnetit të tyre për të investuar në Kosovë. Bazuar në të njëjtën anketë, sektorët e bujqësisë, ndërtimit, arsimit, energjisë, teknologjisë informative (TI) dhe turizmit janë treguar si tërheqës për investimet e diasporës.

Një anketë e mëtejshme e kryer nga Aktiviteti në shkurt të vitit 2024, me 89 të anketuar nga diaspora, zbuloi se pothuajse 80% kishin planifikuar të investonin në Kosovë. Rreth dy të tretat e të anketuarve deklaruan se do të investonin në Kosovë së bashku me një partner tjeter investues, ndërsa pothuajse 40% deklaruan se do të investonin përmes një kredie bankare. Veçanërisht, përkundër mostrës së kufizuar, të anketuarit nga diaspora deklaruan se do të preferonin të

investonin mesatarisht €1 milion në Kosovë. Gjashtëdhjetë përqind (60%) e të anketuarve deklaruan se qëllimi kryesor i investimit do të ishte eksporti i mallrave dhe shërbimeve. Një e treta e bizneseve të diasporës deklaruan se qasja në financa ishte sfida kryesore për të investuar në Kosovë.

3. Dritarja për Investime të Diasporës

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka ndërmarrë një iniciativë bashkë me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) për të lansuar një program të ri që synon përkrahjen e bizneseve të diasporës në kanalizimin e investimeve të tyre në Kosovë.

Konkretnisht, MFPT dhe FKGK janë pajtuar të themelojnë Dritaren për Investime të Diasporës, e cila është një skemë e re garancie për ndarjen e rrezikut përmes ofrimit të garancive kreditore veçanërisht për investorët dhe bizneset e diasporës. Dritarja për Investime të Diasporës do të ofrojë garanci kreditore për institucionet financiare të regjistruara për të mbuluar një pjesë të rrezikut të mospagesës që lidhet me kreditë e dhëna investitorëve dhe bizneseve të diasporës.

Për të krijuar Dritaren për Investime të Diasporës, Qeveria e Kosovës, konkretisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, do të sigurojë një bazë kapitali prej 8 milionë euro. Përveç kësaj, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore do të sigurojë 2 milion euro kapital shtesë, duke rezultuar në një bazë kapitali të kombinuar prej 10 milionë euro. Sipas Dritares së re për Investime të Diasporës, mbulimi maksimal i garancisë së FKGK-së për një kredi individuale do të jetë 2 milionë euro, duke mundësuar financimin e kapaciteteve të reja të konsiderueshme prodhuase.

Si partner mbështetës i kësaj iniciative të lansuar nga MFPT dhe FKGK, USAID – përmes Aktivitetit për Promovimin e Investimeve dhe Qasja në Financa – do të ofrojë mbështetje në promovimin e dritares së re në tregjet kryesore të diasporës. Qëllimi është që kjo të bëhet nëpërmjet angazhimit të një ofruesi të aftë të shërbimeve që do të implementojë një fushatë gjithëpërfshirëse në terren. Aktiviteti do të zbatojë fushatën e informimit në bashkëpunim të ngushtë me MFPT-në dhe FKGK-në, me qëllim të ndërgjegjësimit të investitorëve të diasporës rrëth përfitimeve të përdorimit të Dritares për Investime të Diasporës. Përveç kësaj, Aktiviteti do të synojë të mbështesë iniciativën e MFPT-së dhe FKGK-së në financimin përmes granteve (shih Pjesën 4 më poshtë) dhe mundësishët shërbimeve këshilluese të tjera që mbështesin investitorët e diasporës për të konsoliduar dhe themeluar bizneset e tyre në Kosovë.

Si përbledhje, Dritarja për Investime të Diasporës do t'u mundësojë investitorëve që të iniciojnë dhe përshkallëzojnë projektet investuese në Kosovë, duke filluar nga bizneset fillestare dhe bizneset e vogla e deri te projektet më të mëdha investuese. Së këndejmi, burime të këtilla financiare janë të nevojshme për të financuar operacionet e bizneseve, blerjen e pajisjeve, punësimin e punëtorëve dhe zgjerimin e shtrirjës në treg.

4. Fondi për Rritjen e Bizneseve të Diasporës

Në mbështetje të Dritares për Investime të Diasporës, financimi stimulues përmes granteve do të sigurohet nga Aktiviteti i USAID-it (Promovimi i Investimeve dhe Qasja në Financa) për përdorim të shumëfishtë nga bizneset e kualifikuar të diasporës, duke përfshirë por pa u kufizuar në konsolidimin e bizneseve, shërbimet e ndryshme këshilluese, blerjen e makinerive dhe

marketingun. Fondi i granteve të Aktivitetit për të mbështetur bizneset e kualifikuara të diasporës do të nijhet si **Fondi për Rritjen e Bizneseve të Diasporës**.

Fondi për Rritjen e Bizneseve të Diasporës do të ndihmojë në zvogëlimin e barrës financiare për investitorët e diasporës duke ofruar mbështetje për shpenzimet e tyre operative, që ata të fokusohen në rritjen e bizneseve të tyre dhe krijimin e mundësive të punësimit në Kosovë.

5. Qëllimi i Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës

Qëllimi i Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës është:

- Zgjerimi i investimeve të drejtpërdrejta të diasporës në ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) dhe në bizneset fillestare të kualifikuara për aplikim.
- Zgjerimi i investimeve direkte në bizneset fillestare me potencial të lartë të ndërlidhura me diasporën, sipërmarrjet e përbashkëta dhe NMVM-të.
- Zgjerimi i qasjes në instrumentet financiare ekzistuese dhe të reja për të mundësuar rrjedhën e kapitalit privat drejt NMVM-ve të ndërlidhura me diasporën.
- Stimulimi dhe lehtësimi i transferimit të njohurive dhe kapitalit investues të diasporës tek kompanitë vendore.

Përmes Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës, Aktiviteti fton aplikantët potencial të kualifikuar që të paraqesin propozime për financimin e iniciativave të mëposhtme:

- Konsolidim të biznesit.
- Trajinim të stafit.
- Menaxhim organizativ.
- Planifikim afarist dhe financiar.
- Blerje të pajisjeve.
- Shërbime të marketingut.
- Shërbime të tjera këshilluese, sipas rastit.

Aktiviteti inkurajon aplikantët e interesuar për të siguruar financim përmes Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës që ta shohin këtë mundësi më shumë sesa thjesht përfitim i një granti. Qëllimi i financimit është të nxisë partneritetet ndërmjet Aktivitetit dhe bizneseve/investitorëve të aftë të diasporës për të punuar së bashku drejt arritjes së objektivave kyçë të zhvillimit ekonomik.

Aktiviteti do të përdorë metoda lehtësuese dhe të bazuara në treg për të aplikuar kështu në mënyrë strategjike grantet për të zvogëluar rrezikun, për të demonstruar ndikimin, për të inkurajuar inovacionin dhe për të zgjeruar aktivitetet gjithëpërfshirëse përgjatë objektivave.

Aplikantët duhet të veprojnë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e iniciativës së Dritares për Investime të Diasporës, të cilat përfshijnë promovimin e zhvillimit ekonomik, nxitjen e sipërmarrjes dhe forcimin e lidhjeve ekonomike dhe tregtare ndërmjet diasporës dhe Kosovës. Investimi që do të mbështetet nga Dritarja për Investime të Diasporës dhe përmes Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës duhet të jetë për qëllime biznesi dhe jo për qëllime private. Blerja e pronave të paluajtshme, rinovimi i banesave dhe qëllimet tjera private, nuk kualifikohen

as për Dritaren për Investime të Diasporës e as për Fondin për Rritjen e Bizneseve të Diasporës të Aktivitetit.

6. Fushat për financim

Përmes Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës, Aktiviteti mirëpret çdo aplikim me ndikim dhe aplikim inovativ që mbështet objektivat e deklaruara, çdo aplikim që sjellë ndikim ekonomik, kontribuon në tërheqjen e investimeve, krijimin e kapaciteteve të reja prodhuese, futjen e produkteve dhe shërbimeve të reja konkurruese, krijimin e vendeve të reja të punës dhe depërtimin e tregjeve të eksportit.

Grantet do të jepen për aktivitetet bzinesore që kanë potencialin më të madh për ndikim të përgjithshëm në fushat në vijim:

- Rritja e investimeve direkte të diasporës.
- Stimulimi i rritjes së biznesit nëpërmjet rritjes së shitjeve dhe/ose eksporteve.
- Prezantimi i produkteve dhe/ose shërbimeve të reja për Kosovën dhe tregjet e eksportit.
- Krijimi i vendeve të reja të punës.

7. Kompanitë e pranueshme

Të gjitha grantet e dhëna në kuadër të Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës të Aktivitetit do të janë subjekt i kërkesave të pranueshmërisë të përcaktuara më poshtë. Sipas Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës, vetëm bizneset të cilave u janë miratuar kredi nga një institucion financiar i regjistruar dhe që janë të vendosura në Dritaren për Investime të Diasporës, do të kenë të drejtë të aplikojnë për grant në kuadër të Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës të Aktivitetit.

Sipas kriterieve të përcaktuara në Dritaren për Investime të Diasporës, kompanitë e pranueshme do të janë:

- Iniciativat e bizneseve të reja që planifikohen të krijojnë, ose ato ekzistuese me histori veprimi jo më të vjetër se në 36 muaj.
- Në rastet e sipërmarrjes së përbashkët për biznes të ri (njojur në anglisht si “start-up”), ideja e biznesit duhet të dokumentohet me një plan të duhur biznesi.
- Në rastet e sipërmarrjeve të përbashkëta për biznes të ri, investitorët ose partnerët vendorë duhet të kenë njohuri përkatëse ose përvojë biznesi, brenda ose jashtë Kosovës, për aktivitetin e planifikuar të biznesit. Ekspertiza (njojuritë) e mëparshme janë thelbësore për suksesin e ardhshëm të biznesit.
- Biznesi ose ndërmarrja duhet të jetë e regjistruar dhe të ketë më pak se 250 punonjës.

Kompanitë e pranueshme duhet gjithashtu të:

- Demonstrojnë aftësi për të kontribuar në objektivat e Aktivitetit dhe për të ekzekutuar shumën e grantit në përputhje me parimet dhe praktikat e USAID dhe DT Global.
- Dëshmojnë menaxhim të shëndoshë financiar, administrativ dhe teknik në formën e një sistemi kontrolllesh që mbron asetat dhe mbron nga mashtrimi dhe shpërdorimi.
- Kenë dëshmi të performancës së kënaqshme dhe dëshmi të integritetit dhe etikës së biznesit.

- Jenë në gjendje të vërtetojnë dhe të nënshkruajnë të gjitha certifikatat e detyrueshme (të listuara në **Shtojcën A**).

Para dhënes së grantit sipas kësaj mundësie financimi, aplikantëve të suksesshëm do t'u kërkohet të nënshkruajnë një certifikatë në lidhje me financimin e terrorizmit që vërteton se organizata e aplikantit nuk ofron dhe nuk ka ofruar asnjëherë ndihmë për terroristët për aktivitete terroriste. Aplikantëve të suksesshëm do t'u kërkohet të nënshkruajnë Certifikata të tjera të zbatueshme për grantin. Certifikatat janë bashkangjitur si **Shtojca A** e kësaj thirrje.

Para dhënes së një granti sipas kësaj thirrje, aplikantët e suksesshëm do t'i nënshtrohen gjithashtu përcaktimit të përgjegjshmërisë para dhënes së grantit, e cila do të zhvillohet nga Aktiviteti. Në marrjen e këtij përcaktimi, Aktiviteti do të përcaktojë nëse aplikanti posedon kapacitetin organizativ, kapacitetin financier, kontrolllet e brendshme, sistemet e prokurimit (nëse kërkohet) dhe dëshmitë e performancës së kaluar në mënyrë që të zbatojë me sukses aktivitetet e grantit. Vetëm organizatat që janë përcaktuar të janë të përgjegjshme do të kenë të drejtë për grant.

Aktivitetet që kanë ndikim negativ mjedisor i cili ndikim nuk mund të zbutet, nuk do të merren parasysh.

8. Rezultatet kryesore të pritshme

Aplikacionet e paraqitura sipas kësaj thirrjeje duhet të demonstrojnë se si kërkesat e tyre për financim dhe aktivitetet e propozuara kontribuojnë në të paktën një nga treguesit e mëposhtëm. Ndërsa aplikacionet vlerësohen nga këndvështrime të shumta, ato që tregojnë qartë potencial më të madh për ndikim në një ose mundësish të shumë tregues të rezultateve të mëposhtme (në kushte tjera të barabarta) do të kenë mundësi më të madhe për financim:

- Rritja e vlerës së investimit të ri.
- Rritja e vlerës së financimit të ri.
- Rritja e numrit të ndërmarrjeve të sektorit privat me qasje të shtuar në financa.
- Rritja e numrit të partneritetave të reja private që çojnë në rritjen e investimeve private.
- Rritja e numrit të lidhjeve të reja ndërmjet biznesit kosovar dhe investitorëve të huaj.

9. Madhësia e granteve dhe periudha e zbatimit

Varësisht nga disponueshmëria e fondeve, çdo shumë që rezulton nga kjo mundësi e financimit pritet të jetë në shkallën prej:

- €5,000 deri në €30,000 (ose ekuivalenti i \$33,000).
- Grantet që janë nën €5,000 ose mbi €30,000 (\$33,000) mund të merren parasysh në rrethana kur janë të arsyetuara mirë, i sjellin vlerë të shtuar qëllimit të fondit dhe miratohen nga USAID.

Periudha e zbatimit të aktivitetave të finançuara është maksimumi **2 vite**.

10. Kontributi në kosto nga përfituesi i grantit

Aplikantët inkurajohen fuqimisht të kontribuojnë në kosto të zbatimit të aktiviteteve të propozuara.

Kontributi në kosto mund të financohet nga burimet e përfituesit ose nga kontributi i miratuar nga një palë e tretë. Të gjitha kontributet duhet të identifikohen qartë dhe të gjitha kostot e caktuara duhet të jenë të arsyeshme dhe në përputhje me kushtet mbizotëruese të tregut të hapur. Kontributet e palëve të treta janë të pranueshme dhe mund të konsiderohen pjesë e kontributit të marrësit, pjesërisht ose tërësisht. Natyra dhe shuma e këtij kontributi do të përcaktohen qartë në Aplikacionin për Grant dhe në Marrëveshjen e Grantit.

11. Kërkesa për Identifikuesin Unik të Subjektit (IUS)¹

Aplikantëve ju kërkohet të sigurojnë numrin IUS nëse përgjedhen për të përfituar grant me vlerë prej \$25,000 ose më shumë. Nëse organizata ka ndonjë përjashtim (sipas 2CFR § 25.110 (b) ose (c)), atyre nuk do t'u kërkohet të sigurojnë IUS.

Është e mundur që një subjekt të marrë IUS pa kryer regjistrimin e plotë në Sistemin per Menaxhimin e Granteve (SAM).

12. Procesi i aplikimit

Kjo mundësi financimi do të ketë proces të vlerësimit me një fazë të vetme. Gjatë procesit të aplikimit, duke përfshirë fazën e para-aplikimit, Aktiviteti mund të përdorë *krijimin e përbashkët* me aplikantët, i cili nënkupton punë të përbashkët me aplikantët e mundshëm dhe në dukje të suksesshëm për të orientuar aplikimet drejt ndikimit më të madh dhe përafrimit me objektivat e Aktivitetit. Fushëveprimi i plotë i asaj që do të përfshijë krijimi i përbashkët me aplikantët është pëershruar në Seksionin 14 më poshtë.

Paraqitura e Aplikimit për Grant

Subjektet e kualifikuara do të dërgojnë aplikacionin për grant (AG). Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen në formatin e Aplikimit për Grant të përfshirë në **Shtojcën B** të kësaj thirrje. Formatit i AG-së kërkon që aplikantët të japid detaje rreth aktivitetit të propozuar të grantit, objektivat e tij, ndikimin e synuar sistemik dhe rezultatet e pritshme, duke përfshirë përshkrimin e përfituesve të synuar dhe palëve të interesit dhe strukturën e propozuar të stafit. Poashtu, në aplikim duhet të përfshihet **Shtojca C** që kërkon nga aplikantët të paraqesin buxhetin e detajuar të grantit. Aplikimi për grant nuk duhet të kalojë 15 faqe. Aplikimet mbi 15 faqe mund të mos shqyrtohen nga Aktiviteti.

Aplikacionet për grant mund t'i dorëzohen Aktivitetit në çdo kohë para datës dhe kohës së myllijes siç specifikohet në këtë thirrje. **Megjithatë, aplikimet e hershme inkurajohen fuqimisht.** Aplikantët duhet të dorëzojnë në mënyrë elektronike **Shtojcën B** dhe **Shtojcën C** përmes e-mailit në adresën grants.ipaf@dt-global.com. Data e fundit për dorëzimin e AG është **31 korrik 2025**, dhe koha e fundit për dorëzimin e AG është **ora 15:00** sipas kohës lokale

¹ IUS - Identifikuesi Unik i Subjektit është një ID alfanumerike me 12 karaktere që i caktohet një subjekti nga SAM.gov.

të Kosovës (Koha e Evropës Qendrore) në atë datë. AG të dorëzuara pas kësaj date dhe ore nuk do të merren parasysh në këtë DVP.

13. Vlerësimi dhe përzgjedha

Aktiviteti do të caktojë Komisionin Vlerësues të Granteve (KVG) që do t'i shqyrtojë në baza të vazhdueshme AG-të e paraqitura në përgjigje të kësaj mundësie për financim.

KVG do të vlerësojë AG-të bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit	Aspektet kryesore të vlerësimit	Pikët
Ndikimi	Cili është ndikimi i pritur në investimet e reja, dhe treguesit tjerë kyçë të Aktivitetit?	20
Qëndrueshmëria financiare	Cila është pjesëmarrja e investimeve në kapital dhe financimi bankar në planin total të investimeve?	30
Inovacioni	Çfarë inovacioni do të sjellë përfituesi potencial i grantit/biznesi? Produkte të reja? Shërbime të reja?	10
Përshkallëzimi i aktiviteteve	Sa mund të përshkallëzohet/shpërndahet iniciativa e propozuar investuese?	10
Kapaciteti i aplikantit	A ka aplikanti përvjohë përkatëse në të kaluarën në zbatimin e një plani të ngashëm të biznesit? A ka aplikanti burime të mjaftueshme njerëzore, teknike, menaxheriale dhe burime të tjera në dispozicion për të zbatuar me sukses aktivitetin e propozuar?	10
Qëndrueshmëria	Sa e besueshme është që përfituesi i mundshëm i grantit do të vazhdojë aktivitetin pa mbështetje të grantit?	10
Efektiviteti i kostos dhe kontributi në kosto nga aplikanti	Çfarë niveli të kontributit në kosto do të sigurojë aplikanti për të rritur koston e grantit? A është buxheti i propozuar realist, i menduar mirë dhe në përputhje me aktivitetet e propozuara? A janë kostot e propozuara të arsyeshme, të lejueshme dhe të alokuara për grantin?	10
Gjithsej		100

Aktiviteti rezervon të drejtën për të financuar ndonjë ose asnjë nga aplikimet e paraqitura. Lëshimi i kësaj thirrje nuk përbën zotim për dhënie të grantit nga ana e Aktivitetit dhe as nuk e detyron Aktivitetin të paguajë për kostot e shkaktuara për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit për grant. Më tej, Aktiviteti rezervon të drejtën të refuzojë ndonjë ose të gjitha aplikacionet e pranuara nëse një veprim i tillë konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të Qeverisë së SHBA-ve. **Përgatitja dhe dorëzimi i aplikacionit është risk i aplikantit; nëse rrethanat pamundësojnë dhënien e grantit, e gjithë kostoja e përgatitjes dhe dorëzimit bartet nga vetë aplikanti.**

14. Krijimi i përbashkët me aplikantët

Në përputhje me procesin e aplikimit të përshkuar në seksionin 12 të këtij dokumenti, Aktiviteti mund të *bashkë-krijojë* në mënyrë aktive dhe të ngushtë aktivitete dhe propozime me aplikantët e mundshëm. Ky proces mund të përfshijë krijimin e përbashkët një-më-një ose me shumë aplikantë. Krijimi i përbashkët është praktikë e lejuar në kuadër të projekteve të USAID-it me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ndërhyrjeve bazuar në një bashkëpunim proaktiv ndërmjet financuesit dhe implementuesve të mundshëm.

Për më tepër, krijimi i përbashkët ofron hapësirën e nevojshme ndërmjet Aktivitetit dhe aplikantëve potencialë për të përfshirë kontributin e sektorit privat dhe akterëve të tjerë të rëndësishëm në procesin e identifikimit të problemeve dhe propozimit të zgjidhjeve. Nëpërmjet krijimit të përbashkët, Aktiviteti mund të vërtetojë më tej dhe të zërthejë kufizimet që pengojnë flukset e investimeve dhe financave përmes përpjekjeve të përbashkëta bashkëpunuese me partnerët e interesuar. Krijimi i përbashkët mund të çojë gjithashtu në një kuptim më të mirë të interesave dhe objektivave të partnerëve, duke përmirësuar kështu zotimin ndërmjet partnerëve.

Për të maksimizuar kontributin dhe bashkëpunimin përbajtësor në hartimin e propozimeve të suksesshme, procesi i mësipërm i krijimit të përbashkët do të karakterizohej me komunikim të vazhdueshëm dhe të gjerë ndërmjet Aktivitetit, sektorit privat, partnerëve të mundshëm implementues dhe partnerëve të tjerë të mundshëm, siç janë subjektet përkatëse qeveritare dhe joqeveritare. Përmes krijimit të përbashkët, Aktiviteti mund të ketë diskutime të detajuara dhe të gjëra me partnerët përkates gjatë gjithë procesit, nga angazhimi i hershëm me akterët kryesorë për qasjet dhe zgjidhjet e mundshme para paraqitjes së aplikimeve për grant, deri në hartimin përfundimtar dhe negocimin e marrëveshjeve ose shumave.

Krijimi i përbashkët nga Aktiviteti do t'ia mundësojë projektit të angazhohet me aplikantët e mundshëm në çdo fazë të procesit të aplikimit, përfshirë periudhën para aplikimit, në formën e sesioneve të diskutimit të ideve me partnerët rrëth ideve të mundshme të ndërhyrjes që mund të financohen nga kjo thirrje.

Këto angazhime mund të ndihmojnë Aktivitetin dhe partnerët të fillojnë formulimin e ndërhyrjeve, aktiviteteve dhe qasjeve të mundshme. Angazhimi para aplikimit me partnerët mund të jetë i nevojshëm për të kuptuar më mirë sfidat specifike që kanë të bëjnë me çështjen dhe akterët e saj dhe për të eksploruar rrugët për miratimin e ndryshimit sistematik.

Pasi të paraqitet aplikimi për grant, Aktiviteti mund të angazhohet me aplikantin(ët) për të ndërtuar, zhvilluar dhe përmirësuar më tej qasjen e përgjithshme dhe aktivitetet e propozuara. Gjatë kësaj faze, nuk do të ishte e pazakontë, nëpërmjet një procesi tejet bashkëpunues të krijimit të përbashkët, që idetë dhe aktivitetet të zhvillohen ndjeshëm, ndërsa partnerët rafinojnë qasjet e tyre për të identifikuar mënyrën më të mirë për të arritur rezultate më të mira.

Duke u angazhuar në krijim të përbashkët, Aktiviteti do të sigurojë gjithashtu se ekzistojnë masa të rrepta mbrojtëse për të shhangur sfidat e konfliktit të interesit. Konkretisht, Aktiviteti do të sigurojë që të mos krijohet asnjë avantazh konkurrues i padrejtë për asnjë subjekt. Aktiviteti do të përpinqet në masën maksimale të mundshme për të siguruar që të gjithë partnerët e mundshëm implementues të kenë qasje në informacion të barabartë. Nëse ndonjë informacion jopublik shpaloset gjatë krijimit të përbashkët, kjo do të bëhet me mirëkuptimin e akterëve të përfshirë në mënyrë që i njëjti informacion të vihet në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara që dëshirojnë të aplikojnë. Aktiviteti do të sigurojë gjithashtu që shansi i barabartë t'u ofrohet të

gjithë aplikantëve, pavarësisht nga pjesëmarrja e tyre në diskutimet e krijimit të përbashkët me projektin.

15. Zbutja e deformimit të tregut

Aktiviteti do të sigurojë procedura të qarta, transparente dhe konkuruese për grantet e finançuara nga projekti, duke përfshirë çështjet kyçë që ndërlidhen me rezultatet e pritura, deformimin e tregut dhe kontributin e kostove të shtuara. Propozimet për grante do të vlerësohen dhe miratohen me qëllim të shmangies se deformimit të tregut ose favorizimin e një subjekti ndaj një tjeteri.

Qëllimi i programit të granteve të Aktivitetit nuk është që të përdoret si financim i drejtpërdrejtë ose ofrimi i subvencioneve, por për të avancuar konkurrencën e përgjithshme brenda fushave të fokusit të Aktivitetit. Fondi nuk do të përdoret për të ofruar subvencione të padrejta që konkurrojnë me institucionet financiare ekzistuese. Fondi do të strukturohet dhe menaxhohet për të siguruar që ai të mos deformojë tregun vendor. Kriteret kryesore për rishikimin dhe miratimin e granteve do të janë përfitimet e pritshme kuantitative dhe kualitative të aktivitetit të propozuar, duke përfshirë vlerësimet e arsyeshme të rritjes së investimeve dhe financave që do të gjenerohen në krahasim me koston totale të aktivitetit dhe pjesën e propozuar të kostos. Të gjitha grantet, dhe në veçanti ato për firmat fitimprurëse, do të përfshijnë dispozita të përshtatshme për të siguruar që të ardhurat e programit të përdoren për të çuar më tej objektivat e pranueshme të programit.

16. Faza para grantit, aplikimi për grant, vlerësimi dhe zbatimi

Hapja e mundësisë për grant

Aktiviteti harton dhe publikon kërkesën për mundësi financimi (Fondi për Rritjen e Bizneseve të Diasporës: APS-2024-002) në portalet vendore të punës dhe në Rrjetin Kosovar për Investime dhe Financa në

<https://www.facebook.com/KosovoInvestemandFinanceNetwork>



Aplikanti financohet nga institucioni finanziar i regjistruar (IFR) përmes kredisë dhe nënshkruhet kontrata e kredisë

Aplikanti ka nënshkruar kontratën e kredisë me institucion finanziar të regjistruar dhe kredia është disbursuar



IFR regjistron produktin kreditor në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore

Kredia e disbursuar nga IFR regjistrohet në FKGK nën Dritaren për Investime të Diasporës



Aplikanti i aprovuar nga banka dhe FKGK pastaj paraqet Aplikimin për Grant (AG) në kuadër të Fondit për Rritjen e Bizneseve të Diasporës të Aktivitetit

Aplikanti plotëson dhe dorëzon Aplikimin për Grant dhe kontratën e kredisë në Aktivitet dhe adreson të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe vlerësimit që duhet të merren parasysh për një grant.



Aktiviteti konfirmon me FKGK-së se kredia është e regjistruar në Dritaren për Investime të Diasporës

Aktiviteti konfirmon se aplikanti ka një kredi të miratuar duke përfshirë garancinë e kredisë nga FKGK



Aktiviteti vlerëson AG-në dhe buxhetin

Aktiviteti shqyrton dhe vlerëson Aplikimin për Grant kundrejt kritereve të vlerësimit dhe njofton aplikantin për rezultatet e AG-së.



Nëse kërkesa është e suksesshme, Aktiviteti dhe Aplikanti lidhin një marrëveshje për grant

Aktiviteti lidh një marrëveshje për grant me aplikantin e suksesshëm.



Implementimi i aktivitetit të grantit

Përfituesi i grantit zbaton aktivitetet e grantit siç përcaktohet në marrëveshjen për grant. Aktiviteti monitoron zbatimin e pikave kyçe të grantit dhe rezultatet e arritura dhe bën disbursimet e grantit kundrejt kompletimit me sukses të etapave kyçe dhe të rezultateve.



Përfundimi/mbyllja e grantit

Pas kompletimit të suksesshëm të të gjitha etapave kyçe dhe arritjes së rezultateve të pritura sipas marrëveshjes së grantit, Aktiviteti vërteton se granti është zbatuar me sukses.

17. Administrimi i dhënies së grantit

Në bazë të 2 CFR 200 Nënpjesa E dhe 2 CFR 700.13, është politikë e USAID-it që mos të lejojë profit përmes instrumenteve të asistencës. Megjithatë, të gjitha shpenzimet e arsyeshme, të alokueshme (në projekt) dhe të lejueshme, direkte dhe indirekte, të cilat lidhen me aktivitetin e grantit dhe janë në përputhje me standartet e aplikueshme të kostos (Rregullorja Federale për Blerje (FAR) Pjesa 31.2 për organizatat fitimprurëse), mund të paguhen sipas grantit.

Çdo grant i dhënë do t'i nënshtrohet termave dhe kushteve të Kontratës Kryesore për Aktivitetin.

I. Shtojcat

- A. Shtojca A: Certifikatat, Garancitë dhe Deklaratat e tjera të ofertuesve.
- B. Shtojca B: Formulari i aplikimit për grant.
- C. Shtojca C: Formulari i buxhetit (Excel).